

CILAT JANË TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE?

Shoqëria Administruese aplikon tarifë të mëposhtme:

1. Tarifa e administrimit të Fondit është 2.5% në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit.
2. Në rastin e transferimit të aseteve nga anëtarë në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet është 0.5% e shumës së transferuar.

KUR MUND TË TËRHIQEN FONDET E AKUMULUARA?

Çdo anëtar i Fondit ka të drejtë të përfitoj shumën e akumuluar në fond kur përmbush kushtet e mëposhtme të parashikuara në ligj:

1. Kur mbush moshën e pensionit të parashikuar në ligjin për sigurimet shoqërore;
2. 5 vjet përpara se të mbush moshën e pensionit të parashikuar në ligjin për sigurimet shoqërore;
3. Kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme.

CILAT JANË MËNYRAT E TËRHEQJES?

Asetet e akumuluar mund të tërhiqen në format e mëposhtme:

1. Pagesë e menjëhershme e të gjithë vlerës ose një pjese të saj;
2. Pagesë periodike e planifikuar në formë pensioni;
3. Përdorim i shumës së akumuluar për të blerë një "të përvitshme (anuitet)";
4. Kombinim i mënyrave të pikave 1, 2 dhe 3 si më sipër.

TËRHEQJET E PARAKOHSHME

Në rastin e tërheqjes së parakohshme Shoqëria Administruese do të aplikojë penalitete, të parashikuara në ligj, të cilat do të llogariten mbi vlerën neto të aseteve të tërhequra, dhe më konkretisht:

- 2%, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë;
- 5%, për çdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
- 10%, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
- 15%, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të;
- Në rastet kur anëtarë humb jetën, penalteti i tërheqjes së parakohshme nuk aplikohet.



FONDI
I PENSIONIT
VULLNETAR
ALBSIG

TIRANA BANK

INFO BANK: 0800 68 68 (nëpërmjet telefonave fiks, 24/7)
Tel: 04 2277 700 (nëpërmjet celularit dhe telefonave fiks, 24/7)
www.tiranabank.al



ALBSIG Invest sh.a.
NUIS: L92208025J
+355 (0) 42254764
info@albsiginvest.al
www.albsiginvest.al
Rr. "Barrikadave", Albsig HQ, Kati 8, Tiranë - Shqipëri

Përfitoni zbritje në të gjitha produktet
e sigurimeve dhe kartën e anëtarësimit.

TIRANA BANK
KËTU PËR JU

www.tiranabank.al

KUSH ËSHTË ALBSIG INVEST SH.A?

Shoqëria Administruese "Alsig Invest Sh.a" është një shoqëri aksionare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT: L92208025J, e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me vendimin nr. 210, datë 22.11.2019 për të menaxhuar fonde pensioni vullnetar dhe fonde investimi, me seli në adresën: Rruga e Barrikadave, Pallati Alsig, Kati 8, Tiranë. Aktualisht Alsig Invest administron Fondin e Pensionit Vullnetar Alsig dhe Fondin e Investimit Alsig Standard.

ÇFARË ËSHTË FONDI I PENSIONIT VULLNETAR ALBSIG?

Fondi i Pensionit Vullnetar Alsig, është i përbërë nga një grup asetesh, të investuara nga kontributet e anëtarëve dhe zotërohet bashkërisht nga të gjithë anëtarët ku pjesët përpjesëtimore të pronësisë përfaqësohen nga kuota në fond. Fondi i Pensionit Vullnetar Alsig, është një alternativë për të pasur të ardhura shtesë përveç pensionit shtetëror.

PËRSE ËSHTË KRIJUAR FONDI I PENSIONIT ALBSIG?

Fondi i Pensionit Vullnetar Alsig është krijuar si një alternativë investimi për personat që dëshirojnë të kenë një pension më të lartë se ai shtetëror, ku si pasojë e rritjes së jetëgjatësisë nuk u siguron të ardhura të mjaftueshme një pjese të madhe të popullsisë, kur arrijnë moshën e pensionit. Gjithashtu është një mundësi për ata persona që nuk kanë kont

KU INVESTOHEN KONTRIBUTET?

Fondi i Pensionit Vullnetar Alsig investon kryesisht në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aseti me rrezikun më të ulët ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve. Aktualisht fondi përbëhet nga një grup obligacionesh të Republikës së Shqipërisë, të investuara nga kontributet e derdhura nga anëtarët.

MËNYRAT E ADERIMIT NË FOND

•Skema Profesionale:

Në skemën profesionale punëdhënësi dhe punëmarrësi (individit) kontribuojnë së bashku në llogarinë e hapur për punëmarrësin (individin).

•Skema Individuale:

Në skemën individuale vetëm individit kontribuon në masën e dëshiruar.

KU BËHET PAGESA E KONTRIBUTEVE?

Çdo pagesë kontributesh do të kryhet në numrin e llogarinë së Fondit IBAN AL76 2061 1004 0000 1003 2114 7100, të hapur pranë bankës depozitare, Banka Tirana Sh.a, me të cilin shoqëria administruese ka lidhur një marrëveshje.

PËRFITIMET E INDIVIDËVE NGA ANËTARËSIMI NË FOND

- Kontributet individuale janë të zbritshme nga paga bruto për efekt llogaritje të tatimit mbi të ardhurat personale.
- Fondi i pensionit vullnetar është i trashëgueshëm dhe i transferueshëm.
- Mundësia e tërheqjes së fondit të pensionit vullnetar 5 vite përpara moshës së pensionit të parashikuar në ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm.
- Depozitim i shumave të vogla nën minimumin e kërkuar të depozitave apo të bonove të thesarit dhe mundësia e kryerjes së pagesave në mënyrë automatike çdo muaj.
- Mundësia e kthimit të investimit të akumuluar në pagesa në formë pensioni duke vijuar të akumulosh sërish interesa si dhe fleksibilitet të lartë në mënyrat e tërheqjes së pensionit.
- Fondet e pensionit ofrojnë diversifikimin e investimeve në krahasim me investimet individuale.
- Investimet menaxhohen nga profesionistë të specializuar për të kryer investimet e duhura për fondin e pensionit gjë që ndikon pozitivisht mbi normën e kthimit nga investimi.
- Anëtarët pajisen me një përdorues dhe fjalëkalim, të cilin mund ta përdorin për të monitoruar online në çdo kohë llogarinë e tyre personale.
- Anëtarësimi në Fondin e Pensionit Vullnetar Alsig është një domosdoshmëri për këdo pasi pensioni shtetëror zëvendëson mesatarisht vetëm 35% të të ardhurave tuaja aktuale, ndërkohë që kjo shkallë zëvendësimi duhet të jetë të paktën 75%, në mënyrë që të ruani një standard të mirë jetese.

PËRFITIMET E BIZNESEVE NGA ANËTARËSIMI NË FOND

- Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij vlerësohen si shpenzim i zbritshëm për qëllime të tatimit mbi fitimin.
- Punëdhënësi përcakton një periudhë besimi (vesting period), gjatë së cilës punëmarrësi duhet të punojë në kompani për të përfituar këtë investim të punëdhënësit. Kjo periudhë është përcaktuar në ligj të jetë jo më shumë se 2 vjet.
- Fondi i Pensionit do krijojë një kartë besimi ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe në këtë mënyrë do sjellë ulje të "qarkullimit" të punonjësve.
- Tashmë shumë kompani e përfshijnë Fondin e Pensionit si pjesë të politikave të burimeve njerëzore, duke diferencuar biznesin e tyre nga bizneset e tjera konkurrense.
- Punonjësit e një kompanie që ofron përfitime shumëdimensionale, ale, do jenë më të motivuar dhe më produktiv.
- Kontributet individuale janë të zbritshme nga paga bruto për efekt llogaritje të tatimit mbi të ardhurat personale.

SI REALIZOHET KONVERTIMI I KONTRIBUTEVE NË KUOTA?

Shoqëria Administruese konverton në kuota pensioni kontributet e investuara në Fond, sipas çmimit të kuotës së një dite më parë. Çdo kuota pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie të aseteve në Fond.

Shembulli i blerjes së kuotave të pensionit:

ÇMIMI I KUOTËS SË PENSIONIT	1,500.00 LEKË
Kontributi	3,000.00 lekë
Numri i kuotave të anëtarit në Fond: (3,000.00 lekë/ 1,500.00 lekë)	2 kuota

Nëse pas një periudhe të caktuar çmimi i kuotës do rritej në 1,600 Lekë, vlera e aseteve të anëtarit do jetë e barabartë me 2 (kuota) x 1,600 lekë = 3,200 lekë.

Kur një anëtar në Fond ndërpret pagesën e kontributit përkohësisht apo përgjithmonë, ligji i jep të drejtë të mbetet anëtar në Fond me të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të fondit të pensionit.

Shembull për përfitimin tatimor nga zbritja/kursimi nga paga bruto:

	ARBENI	BLERINA
Paga bruto	85,000	85,000
Kontributi për pension	0	2,000
Paga e tatueshme	85,000	83,000
Tatimi	7,150	6,890
Paga mbas tatimit	77,850	76,110
Kontributi mbas pagesës së taksës	2,000	0
Paga neto	75,850	76,110

Përfitimet e të kursyerit në një kohë sa më të hershme:

	KURSIM I HERSHËM	SHTYRJA E KURSIMIVE
Metoda e kursimit	Investo 2,000 Lekë në vit për 10 vitet e para dhe asnjë investim për 20 vite në vazhdim.	Mos investo gjatë 10 viteve të para, por investo më pas për 20 vite nga 2,000 Lekë në vit.
Shuma totale e kursyer	2,000 x 10 = 20,000	2,000 x 20 = 40,000
Vlera në fund të 30 viteve	145,846	98,846

Fillo të kursesh sa më herët,
që të përfitosh nga interesi i përbërë.